



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jediniça Org.Unit	APP2
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	01
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4879-2/24
Data: Datum: Date:	15.03.24
PRISHTINË / A	
Nr. 1	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stallog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	05.03.2024
REFERENC-Ë:	4879/23 - ZSP- 2024
PËR/ZA/TO:	„KORAL KORPORATION” Sh.p.k. K. F.KOSOVË,
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvëndësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pëlqim ujqor

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv, me Nr.të protokollit: 4879/23, parashtruar nga „Koral Corporation”, Sh.p.k., K. F.Kosovë dhe ka vendosur si në Ndryshim Vendim për Pëlqim ujqor, nga “Sole Kosova” Sh.p.k., K. F. Kosovë në “Koral Corporation” Sh.p.k. K. F.Kosovë, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

LU


Datë: 05.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e palës „**KORAL CORPORATION**” Sh.p.k., F.Kosovë, me Nr.prot. 4879/23, për bartje të Pëlqimit Ujor, për shkarkim të ujërave nga fabrika për përpunimin e produkteve të mishit dhe pemëve, nga „**SOLE KOSOVA**” Sh.p.k. K. F.Kosovë, në „**KORAL CORPORATION**” Sh.p.k. F.KOSOVË, nën kushtet vijuese:

1. Pala duhet të përmbahet të gjitha kushteve të pëlqimit ujor, për shkarkim të ujërave nga fabrika për përpunimin e produkteve të mishit dhe përpunimit të pemëve, me Nr. 6057/22 -ZSP- 2022, datë 17.10.2022;




## ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Legjislacionin për Ujërat e Kosovës, vendimit për pëlqim ujqor, me Nr.: 6057/22 - ZSP- 2022, datë 17.10.2022; Bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur si: Formularin e kërkesës për bartje të pëlqimit ujqor-për shkarkim të ujërave; Kopjen e pëlqimi ujqor; Certifikaten e regjistrimit të biznesit të ARBK ( 810492629 ), “Sole Kosova” dhe “Koral Corporation”, si dhe certifikata e biznesit për “Koral Corporation” sh.p.k. , me nr të njëjtë ( 810492629 ); Vërtetimin nga ARBK lidhur me ndrrimin e emrit nga “Sole Kosova “ sh.p.k. në “Koral Corporation”, sh.p.k.

- “Sole Kosova” ka poseduar pëlqim ujqor, me Nr: Protok 6058/22 –ZSP- 2022, datë 17.10.2022;
- Kërkesës për ndryshim të emrit nën kushtet e njëjta të pëlqimit ujqor paraprak nga “Sole Kosova “ sh.p.k. në “Koral Corporation” sh.p.k.
- Vërtetimit për ndryshim të emrit nga “Sole Kosova “ në “Koral Corporation” nga ARBK, me nr protokoli 133 , datë 06.03.2023 i cili e posedon edhe numrin e njëjtë të certifikates së biznesit si më parë,
- Shikimit në vend nga zyrtar të ARPL-së, ku edhe është mbajtur procesverbali i nënshkruar nga Pala dhe Zyrtar të ARPL-së, me datë 01.02.2024;
- Pagesës së bërë me rastin e aplikimit për ndryshim të emrit, sipas shtojces 6 të “U.A. 03/2018 për procedurat për Leje Ujqore” në vlerë prej 200 €, është vendosur si në vendim të pëlqimit ujqor për “Koral Corporation”, ku pala duhet që të i përmbahet të gjitha kushteve të Pëlqimit ujqor paraprake, me që vetëm emri është ndryshuar dhe kushtet mbesin të njëjta për palën.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



**KËSHILLA JURIDIKE :**

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 4879/23 - ZSP - 2024, datë: 05.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës F.Kosovë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI